KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 2432 Prot.
Datë, më 01.04.2025

QËNDRESA QYTETARE

Tiranë, më datë 1.4.2025

**ANKIM**

**ANKUES:** **Qendra "Qëndresa Qytetare"**, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga "Ali Pashë Gucia", Pallati nr. 42 me adresë elektronike qendresaqytetare@gmail.com, me Drejtor Ekzekutiv Z. Rigels Xhemollari, përfaqësuar me autorizim nga **Z. Dhimitër Zguro.**

**DREJTUAR:** **Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.**

**OBJEKTI:** 1. Shfuqizimi i Vendimit nr. 366, datë 28.03.2025 "Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 47, datë 24.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra 'Qëndresa Qytetare'".
2. Konstatimi i shpërdorimit të burimeve publike.
3. Vendosja e sanksioneve administrative ndaj personave përgjegjës.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 91, 124/1 dhe 171, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 *"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"*, të ndryshuar.
Nenet 3 dhe 10, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*", të ndryshuar.

---

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Më datë 28.03.2025, jemi njohur me Vendimin nr. 366, datë 28.03.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet të cilit, është vendosur *"Pushimi i shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 47, datë 24.02.2025"*, i cili nuk është publikuar ende. Duke mos qenë aspak dakord me këtë vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 124/1, të Kodit Zgjedhor, paraqesim këtë ankim bazuar në faktet, të drejtën e aplikueshme dhe analizën ligjore si vijon:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Elisa Spiropali, ka nisur në muajin Tetor iniciativën "Kuvendojmë për Shqipërinë", që sipas informacioneve të Kuvendit, ka për synim informimin e qytetarëve për nismat në interes të tyre, për të mbledhur opinione dhe zgjidhje mbi projektligje të caktuara **[Prova nr. 1 – Shkresa me nr. 600/1 prot., datë 21.02.2025]**. Sipas të njëjtës shkresë, jemi informuar se, gjatë turit "Kuvendojmë për Shqipërinë", Kryetarja e Kuvendit ka pjesë të agjendës takime me të zgjedhurit vendor, qytetarë, grupe interesi, gjithashtu dhe sesione informimi për të rinjtë. Po ashtu, nga ana e Kuvendit na është komunikuar se, kjo iniciativë vjen në kuadër të përmbushjes së angazhimeve që rrjedhin nga Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë 2020 – 2025 **[Prova nr. 2 – Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë 2020 – 2025]**. Megjithatë, sikundër u provua dhe gjatë hetimit administrativ, as Plani Strategjik dhe as Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit Strategjik, i cili përmban në mënyrë të detajuar veprimtaritë dhe aktivitetet konkrete të planifikuara me qëllim realizimin e objektivave strategjike nuk përmbajnë apo parashikojnë organizimin e ndonjë iniciative si "Kuvendojmë për Shqipërinë" **[Prova nr. 3 – Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit Strategjik]**.

2. Në kuadër të kësaj iniciative, Kryetarja e Kuvendit ka zhvilluar deri më datën e depozitimit të këtij kallëzimi, tre ture, nga ku turi i parë, është zhvilluar më datë 22.10.2024 dhe ka përfshirë Bashkitë Berat, Kuçovë dhe Dimal **[Prova nr. 4 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 22 Tetor 2024]**, turi i dytë, është zhvilluar më datë 28.01.2025 dhe ka përfshirë Bashkitë Elbasan, Belsh dhe Peqin **[Prova nr. 5 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 28 Janar 2025]**, ndërsa turi i tretë i takimeve është zhvilluar më datë 11.02.2025 dhe ka përfshirë Bashkitë Himarë dhe Vlorë **[Prova nr. 6 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 11 Shkurt 2025]**.

3. Në të tria rastet, Kryetarja e Kuvendit, së bashku me Kryetarët e Bashkive Dimal, Peqin, dhe Himarë, kanë vizituar institucione të arsimit parauniversitar, më konkretisht, shkollën 9 – vjeçare "Meleq Gjozi" në Gorican, Dimal, gjimnazin "Zihni Magani" në Peqin, dhe gjimnazin "Spiro Gjiknuri" në Himarë. Sipas denoncimeve publike, në mënyrë të detyrueshme është ndërprerë procesi mësimor, me qëllim pjesëmarrjen dhe dëgjesën e Kryetares së Kuvendit, e cila në fjalimin e saj, ka përdorur propagandë politike **[Prova nr. 7 – Denoncimi i shpërndarë në rrjetin social Facebook]**.

4. Më datë 28.01.2025, krahas takimit me Kryetarin e Bashkisë Peqin dhe vizitës në gjimnazin "Zihni Magani", Peqin, Znj. Spiropali ka zhvilluar takim me kryetarin e Bashkisë Belsh Arif Tafani, takim në një bujtinë, takim me kryetarin e Bashkisë Elbasan, një drekë pune dhe takimin e titulluar "Kuvend-On" në ambientet e Teatrit Skampa. Ndonëse të gjitha këto aktivitete janë cilësuar si pjesë normale dhe rutinore e punës së Kryetares së Kuvendit, në fakt këto aktivitete janë qartësisht të një natyre elektorale. Ky fakt provohet qartazi nga takimi i zhvilluar në ambientet e Teatrit "Skampa".[1] **[Prova nr. 8 – Transkript i shkurtuar i takimit]**. Për më tepër, në të njëjtën ditë, Kryetarja e Kuvendit është takuar me përfaqësuesit e Partisë

[1] https://fb.watch/xYbzFB1Zdq/

takuar me përfaqësuesit e Partisë Socialiste në Qarkun e Elbasanit, si: Z. Florenc Spaho, Znj. Dasantila Tahiraj, Znj. Evis Kushi, Z. Klevis Xhoxhi, Z. Saimir Hasalla, Z. Gledian Llatja etj.[2] Pra, Kryetarja e Kuvendit, gjatë vizitës së saj në cilësinë e saj publike, vizitë e përballuar me shpenzime nga Buxheti i Kuvendit të Shqipërisë, përgjatë të cilës është shoqëruar nga Garda e Republikës, ka takuar funksionarë të Partisë Socialiste **[Prova nr. 9 – Fotografi të takimit me funksionarët e Partisë Socialiste dhe postimi përkatës].** Për këtë vizitë, po ashtu janë paguar dhe dieta për dy punonjës në masën 1000 Lekë **[Prova nr. 10 – Email i Kuvendit të Shqipërisë].**

**5.** Më datë 11.02.2025, është zhvilluar turi i tretë i takimeve, duke filluar nga Himara dhe vijuar më pas në Vlorë. Gjatë këtij turi, krahas takimeve me kryetarët e bashkive, janë zhvilluar vizita në gjimnazin "Spiro Gjiknuri"; takime me studentë të Universitetit "Ismail Qemali" një darkë me gra biznesmene, si dhe takimi "Kuvend-On". Në këto takime, vërehet edhe prezenca e Z. Bledi Çuçi, prezencë të cilën, Kryetarja e Kuvendit e ka lidhur me qenien e tij zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë **[Prova nr. 11 – Fotografi të takimeve gjatë turit të datës 11.02.2025].** Krahas këtij funksioni, Z. Çuçi mban edhe funksionin e Drejtuesit Politik të Partisë Socialiste në Vlorë. Pikërisht ky fakt, si dhe video e transmetimit të takimit "Kuvend-On", provojnë natyrën tërësisht politike të këtyre aktiviteteve.[3] Sikundër rezulton, gjatë takimit, Znj. Spiropali dhe Z. Çuçi kanë bërë propagandë politike duke përdorur, ndër të tjera, terma si "votuesit tanë", "Për inat të Edi Ramës dhe qeverisë, nuk mund t'i biesh Shqipërisë"; "reformën në drejtësi e kemi bërë me kosto të madhe politike"; "ne e kemi një lloj pengu si qeveri këto vite që qeverisim Shqipërinë" etj. **[Prova nr. 12 – Transkript i shkurtuar i takimit].**

**6.** Sikundër u provua, për këtë takim, Kuvendi ka shpenzuar 60,000 Lekë për përballimin e shpenzimeve që lidhen me dietat e punonjësve, ndërsa Kryetarja e Kuvendit është shoqëruar nga Garda e Republikës në përputhje me detyrimet ligjore **[*Shih* Prova nr. 10].** Po ashtu, ndonëse Kuvendi i Shqipërisë pretendoi se, Z. Çuçi ishte në cilësinë e tij si Nënkryetar i Kuvendit, nuk arriti të provojë se Nënkryetari tjetër i Kuvendit të Shqipërisë të ishte thërritur apo ftuar për të marrë pjesë në këto takime të mbajtura nga Znj. Spiropali.

**7.** Pavarësisht fakteve të sipërcituara dhe provave në dispozicion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të pushojë hetimin administrativ për rastet e denoncuara nga ana e "Qëndresa Qytetare", ndërkohë që për të njëjtat rrethana, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 371, konstatoi shkeljen e dispozitave që lidhen me ndalimin e shpërdorimit të burimeve publike nga ana e Znj. Spiropali.

## II. E DREJTA E APLIKUESHME

**8.** Kodi Zgjedhor:

2 https://www.facebook.com/espiropali/posts/pfbid0DYv1mV1cEoiHPNNZiEY2qz3PwkzdruarUbSmhqBHKBerGnD2wcHvz9FeLhwHasC7l

3 https://fb.watch/xYenja3vM8/

(i) **Neni 91** parashikon: "*1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.*"

(ii) **Neni 124/1** parashikon: "*2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendim.*".

(iii) **Neni 171** parashikon: "*1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.*".

## III. ANALIZA LIGJORE

**9.** Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e vënien në përdorim ose në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në një interpretim të këtij neni, që të ndodhemi përballë shpërdorimit të burimeve publike duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: (i) përdorimi apo vënia në dispozicion e burimeve publike, pavarësisht se kujt i përkasin; (ii) qëllimi i përdorimit, duhet të jetë mbështetja e një kandidati, partie politike apo koalicioni; (iii) përdorimi apo vënia në dispozicion duhet të bëhet në zgjedhje.

**10.** Në lidhje me kushtin e parë, burimet publike duhet të përdoren vetëm për qëllime institucionale dhe nuk duhet të shfrytëzohen për qëllime zgjedhore apo politike. Ky parim rrjedh nga detyrimi i shtetit për të garantuar zgjedhje të lira dhe të drejta, duke ndaluar, ndër të tjera, edhe ato veprime që synojnë të krijojnë perceptimin apo një avantazh të padrejtë për një nga kandidatët, partitë politike apo koalicionet.

**11.** Në rastin konkret, rezulton se iniciativa "Kuvendojmë për Shqipërinë" është një iniciativë e financuar dhe e organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, që nuk është planifikuar as në Planin Strategjik të Kuvendit, dhe as në Planin e Veprimit të Zbatimit të këtij Plani Strategjik, i cili përbën dhe mënyrën sesi Plani Strategjik do të zbatohet dhe zbërthehet në aktivitete dhe veprimtari të ndryshme. Për këtë iniciativë, të konkretizuar në takimet e datës 28

janar 2025 dhe 11 shkurt 2025, të mbajtura ndër të tjera, në Elbasan dhe Vlorë, janë përdorur fonde publike pasi është provuar pagimi i dietave për punonjës publikë, si dhe transportimi i të gjithë pjesëmarrësve, përfshi dhe i Kryetares së Kuvendit, është kryer me fonde publike. Krahas kësaj, Kryetarja e Kuvendit, e shoqëruar nga punonjësit e Gardës së Republikës, të cilët kanë për detyrë ruajtjen e saj, ka zhvilluar, sikundër provohet nga provat bashkëlidhur, takime me deputetë dhe përfaqësues të lartë të Partisë Socialiste, si në Elbasan, ashtu edhe në Vlorë.

**12.** Përsa i takon kushtit të dytë që, përdorimi duhet të jetë bërë për qëllime të mbështetjes së një kandidati, partie politike apo koalicioni, vlerësojmë se, pavarësisht faktit nëse një aktivitet mund të konsiderohet si një veprimtari zyrtare apo publike, sërish mund të ndodhemi përballë shkeljes kur kjo veprimtari ka për qëllim promovimin politik. Për të vlerësuar elementin e promovimit politik, sikundër kemi argumentuar edhe para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duhet të mbahen në konsideratë disa elemente siç mund të jenë retorika e përdorur, adresimi ndaj mbështetësve, angazhimi me figura të caktuara politike etj.

**13.** Në rastin konkret, retorika e përdorur nga Znj. Spiropali, Z. Çuçi dhe zyrtarëve të tjerë ka qenë tërësisht politike.

**13.1.** Kështu, citojmë: ***"Por, jo rrallë, ju shihni në sallën e Kuvendit sjellje që nuk janë të denja as për mejhane,*** *dhe këtu po flas shumë hapur dhe sinqerisht, po flas nga zemra sepse, si kryetare e Kuvendit aty dhe si ministre në parlament më parë, jam vënë në një pozicion të vështirë,* ***jo përballë votuesve tanë, dhe po flas këtu si pjesë e shumicës,*** *por përballë atyre që e shohin Kuvendin e Shqipërisë dhe presin të dëgjojnë aty zërin e tyre, presin të dëgjojnë atë që kanë për të thënë për ta, që ngrejnë zërin për komunitetet e tyre, që ngrejnë zërin për ligjër, që monitorojnë institucionet, qofshin ato të qeverisë apo institucionet e pavarura, që janë të përgjegjshëm, që nuk janë aty për të* ***bërë sherrnajën e ditës që t'i dëgjojë Kryetari i Partisë për t'i vënë në listë, nuk janë aty për të fyer, për të shpifur, për të hedhur balta, nuk janë aty për të përdorur fjalorin që që në klasë të parë, a në kopësht, mësuesit, edukatorët e prindërit tanë na kanë thënë 'mos e përdorni.".***

**13.2.** Po ashtu, citojmë: *"Ne mund të kemi dallime mes nesh për arsye të ndryshme, nga partitë dhe mund të debatojmë, ama debati nuk mund të kthehet në debat antikombëtar.* ***Për inat të Edi Ramës dhe për inat të qeverisë, nuk mund t'i biesh Shqipërisë, nuk mund ta nxjerrësh Shqipërinë, në sytë e vendasve dhe në sytë e partnerëve. Nuk mund të mohosh arritjet që janë realizuar, nuk mund të thuash sot paturpësisht që Shqipëria është një narkoshtet, në mes të Kuvendit të Shqipërisë.*** *Shqipëria nuk është një narkoshtet, por një vend që për pak vite do të jetë anëtar i BE-së me të drejta të plota dhe një vend i respektuar. Të kthesh kokën 10 vite më parë ose më shumë, unë vetë kam studiuar në Kanada dhe në SHBA për 7 vjet, 2 vjet shkollë të mesme dhe 5 vjet në Amerikë në shkollë, dhe po ju them që në ato vite ishte e pamundur të ftoje shoqet e tua, miqtë e tu, të vinin në Shqipëri, sepse përveç bukurive të natyrës nuk dije ku t'i çoje.".*

**13.3.** Në drejtim të vlerësimit të punëve të bëra, përsa i takon reformës në drejtësi, citojmë: ***"Dhe këtë ndryshim, e ka bërë kjo shumicë me kosto të madhe politike,*** *sepse ishte*

*reforma në drejtësi ajo që e largoi opozitën nga Kuvendi në 2019, duke braktisur institucionet dhe duke shkatërruar legjitimitetin demokratik të Kuvendit.".*

**13.4.** Nga ana tjetër, Z. Çuçi, citohet të jetë shprehur se: *"Edhe diçka tjetër, se ishte shteruese Elisa në këtë pikë, dhe është një e vërtetë që ne e kemi një lloj pengu si qeveri këto vite që qeverisim Shqipërinë. Madje, para 5 muajsh patëm dhe një diskutim të hapur me grupin e interesit, pra me pensionistët, në lidhje me këtë çështje.".*

**13.5.** Ndërsa në Elbasan, Znj. Spiropali, citojmë të jetë shprehur: ***"Të jesh e bindur që nuk ka qeveri në botë që nuk do donte t'i bënte pensionet, rrogat dhe përfitimet të gjitha maksimale dhe jo vetëm për vota dhe për arsye elektorale, por edhe pse do t'i jepte kënaqësi të madhe vetes.*** *Por këmbët shtrihen aq sa ke jorganin* ***dhe vetëm regjime që janë të papërgjegjshme bëjnë lëshime të mëdha financiare në kurriz të shtetit kur nuk i kanë financat përkatëse.*** *Ajo që ne kemi bërë deri tani është që financat e shtetit i kemi shëndoshur, i kemi sjellë në binar. Kemi sot të dhëna ekonomike jo se e themi ne, por se thonë të gjithë institucionet ndërkombëtare financiare që i lejojnë Shqipërisë sot për të pasur frymëmarrje më të lirë për të bërë atë që ju thatë, për të rritur rrogat e administratës etj.".*

**14.** Për më tepër, fondet publike janë vënë në dispozicion të mbështetjes së Partisë Socialiste, si parti politike, pasi vetë Znj. Spiropali ka zhvilluar takime gjatë intervalit 14:30 – 16:30, me përfaqësuesit e Partisë Socialiste, duke promovuar në mënyrë të padyshimtë këtë forcë politike, gjë që provohet dhe nga vetë postimi i saj i shoqëruar me përshkrimin "Me super ekipin në super kalanë e Elbasanit #Shqipëria2030".

**15.** Në lidhje me kushtin e tretë, që përdorimi apo vënia në dispozicion e burimeve publike duhet të bëhet në zgjedhje, vlen të theksojmë se, edhe ky kusht plotësohet në rastin konkret. Koncepti i "zgjedhjeve", duke iu referuar rregullit të kuptimit të zakonshëm të përdorur në interpretimin ligjor, është më i gjerë sesa koncepti i "fushatës zgjedhore", pasi zgjedhjet përbëjnë tërësinë e veprimeve që kryhen në funksion të procesit zgjedhor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në veprime të tilla si: hartimi dhe publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në referim të nenit 51, të Kodit Zgjedhor, njoftimin me shkrim të zgjedhësve për përbërësit e tyre zgjedhorë, në referim të nenit 52, të Kodit Zgjedhor, regjistrimin e partive politike si subjekte zgjedhore, kandidatëve apo koalicioneve, në referim të neneve 63 – 65, të Kodit Zgjedhor etj. Në këtë kuptim, fushata zgjedhore mbulohet nga koncepti i zgjedhjeve dhe jo anasjelltas, pasi fushata zgjedhore, në referim të nenit 77, të Kodit Zgjedhor, fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve, dhe në këtë aspekt, ajo përfshihet në kuptimin e zgjedhjeve. Për më tepër që, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, që ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, përdor në mënyrë eksplicite nocionin "për qëllime zgjedhore". Në asnjë rast, qëllimet zgjedhore nuk kufizohen vetëm në fushatën zgjedhore, kjo pasi për vetë faktin se, qëllimi zgjedhor lidhet me pjesëmarrjen në zgjedhje dhe fitimin e pushtetit në mënyrë demokratike, por në asnjë rast, ky qëllim nuk mund të realizohet paraprakisht pa regjistrimin e partisë politike si një subjekt zgjedhor.

**16.** Edhe duke iu referuar parimeve dhe Udhëzimeve të Komisionit të Venecias, të cilat kanë shërbyer dhe për reformimin e Kodit Zgjedhor, procesi zgjedhor është një periudhë që shkon përtej fushatës zgjedhore, duke përfshirë të gjitha aktivitetet në mbështetje të një kandidati të caktuar, partie politike ose koalicioni.[4] Dhe në çdo rast, sipas këtyre parimeve, sikundër është analizuar dhe më sipër, ndalimi i shpërdorimit të burimeve publike nuk duhet të përfshijë vetëm fushatën zgjedhore, por procesin zgjedhor në tërësi, si e vetmja mënyrë për garantimin e parimeve të përgjithshme të zgjedhjeve, të parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe të drejtën kombëtare.

**17.** Përsa më sipër, në kushtet kur plotësohen të tria kriteret kumulative të parashikuara në nenin 91, të Kodit Zgjedhor, në lidhje me përdorimin e burimeve publike në mbështetje të një partie politike, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet të vendosë pranimin e këtij ankimi.

## IV. KONKLUZIONE

**18.** Përsa më sipër, mbështetur në nenet 91, 124/1 dhe pikën 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor dhe në nenet 3, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator *"Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"*, të ndryshuar, përfundimisht,

**K Ë R K O J M Ë**

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 366, datë 28.03.2025 "Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 47, datë 24.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra 'Qëndresa Qytetare'".
2. Konstatimin i shpërdorimit të burimeve publike.
3. Vendosjen e sanksioneve administrative ndaj personave përgjegjës.

Me konsideratë,
**Për "QËNDRESA QYTETARE"**

(________________)
**Dhimitër ZGURO**

**Bashkëlidhur gjeni**:

- Prova nr. 1 – Shkresa me nr. 600/1 prot., datë 21.02.2025.
- Prova nr. 2 – Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë 2020 – 2025.
- Prova nr. 3 – Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit Strategjik.

---

[4] Venice Commission, *Report on the Misuse of Administrative Resources during Electoral Processes*, Strasbourg: 2013.

- Prova nr. 4 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 22 Tetor 2024.
- Prova nr. 5 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 28 Janar 2025.
- Prova nr. 6 – Program aktiviteti "Kuvendojmë për Shqipërinë", 11 Shkurt 2025.
- Prova nr. 7 – Denoncimi i shpërndarë në rrjetin social Facebook.
- Prova nr. 8 – Transkript i shkurtuar i takimit.
- Prova nr. 9 – Fotografi të takimit me funksionarët e Partisë Socialiste dhe postimi përkatës.
- Prova nr. 10 – Email i Kuvendit të Shqipërisë.
- Prova nr. 11 – Fotografi të takimeve gjatë turit të datës 11.02.2025.
- Prova nr. 12 – Transkript i shkurtuar i takimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**
**SHËRBIMI I INFORMACIONIT DHE DOKUMENTACIONIT**
**SHËRBIMI I KOMUNIKIMIT**
**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 600/1 prot.                                                                 Tiranë, më 21.02.2025

Lënda: Kthim përgjigje

**QËNDRESA QYTETARE**
**Rr. "Ali Pashë Gucia"; Pll. 42; Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datën 17.02.2025 dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ju informojmë si vijon

**1. Çfarë është programi "Kuvendojmë për Shqipërinë"?**

Kuvendojmë për Shqipërinë, është një iniciativë, që Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, ka nisur në muajin Tetor për të bashkëbiseduar me qytetarët, për t'i informuar ata mbi nismat në interes të tyre, për të mbledhur opinione dhe zgjidhje që ata propozojnë për projektligje të caktuara, në të gjithë vendin. Kjo iniciativë e Kryetares së Kuvendit, synon të adresojë çështje vendore që kërkojnë zgjidhje në nivel qëndror, përmes rolit të Kuvendit në veprimtarinë ligjbërëse.

**2. Cili është synimi dhe përmbajtja e tij?**

Në prezantimin e kësaj iniciative që është në të njëjtën linjë me qëllimet që ka Java e Gjelbër për deputetët e Kuvendit, Kryetarja në kuadër të kësaj jave, synon të takojë qytetarët për zbatimin e objektivave dhe vizionit strategjik 2020 – 2025, si efektiviteti i ushtrimit të funksionit ligjvënës, qëllimi i ruajtjes së vlerave themelore si përfaqësimi, transparenca, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja.

Është komunikuar gjithashtu synimi i iniciativës për tu realizuar në të gjitha qytetet e Shqipërisë, për të promovuar dialogun midis qytetarëve dhe vendimmarrësve me qëllim zvogëlimin e hendekut mes qytetarit dhe institucionit ligjbërës, si dhe nxitjen e angazhimit konstruktiv duke

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr 4, Tiranë, Shqipëri, tel: [illegible] web: [illegible] email: [illegible]

kontribuuar kështu në avancimin e demokracisë pjesëmarrëse. Deri më sot turi i Kryetares së Kuvendit është zhvilluar në Berat, Kuçovë, Dimal, Elbasan, Belsh, Peqin, Vlorë, Himarë.

Gjatë këtij turi, Kryetarja ka pjesë të agjendës takime me të zgjedhurit vendor, qytetarë, grupe interesi, gjithashtu dhe sesione informimi për të rinjtë mbi programet edukative të ofruara nga Kuvendi i Shqipërisë si turi parlamentar, turi legjislativ, "Këndvështrimi im", "Punishtja e Demokracisë", KuvendON, të cilat synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe njohuritë e të rinjëve mbi funksionimin e institucioneve demokratike dhe rolin e Kuvendit në qeverisjen e vendit, promovimin e platformave të konsultimit publik të nismave ligjore, etj.

**3. Mbi bazën e çfarë akti juridik është miratuar ky program?**

"Kuvendojmë për Shqipërinë", është iniciuar si një mekanizëm në shërbim dhe për përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë 2020-2025, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht objektivat strategjikë:

I. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare.
II. Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e parlamentit.

Nga sa më sipër, Plani Strategjik i Kuvendit ka si një nga objektivat kryesore rritjen e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit. Në këtë kontekst, turi "Kuvendojmë për Shqipërinë" është një instrument kyç për zbatimin e këtij objektivi strategjik, duke krijuar ura komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe Krtyetares së Kuvendit.

Iniciativa siguron akses të drejtpërdrejtë të qytetarëve në informacion mbi funksionimin e Kuvendit, proceset ligjvënëse dhe vendimmarrjen.

Kryetarja e Kuvendit angazhohet në komunikim të hapur me qytetarët, duke forcuar besimin dhe llogaridhënien institucionale.

Përmes aktiviteteve interaktive dhe takimeve publike, qytetarët të shprehin mendimet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre mbi çështje me rëndësi kombëtare dhe lokale, me qëllim forcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe mundësimin e politikave më të orientuara drejt nevojave të komuniteteve, grupeve të interesit dhe qytetarëve në përgjithësi.

Iniciativa shërben si një platformë edukimi, duke ndihmuar qytetarët të kuptojnë më mirë rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e Kuvendit.

Përmirëson ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në një shoqëri demokratike, duke nxitur një kulturë më aktive të pjesëmarrjes në jetën publike.

"Kuvendojmë për Shqipërinë" është një mekanizëm efektiv për zbatimin e strategjisë së Kuvendit, duke përmirësuar transparencën institucionale, angazhimin qytetar dhe edukimin mbi proceset

demokratike. Përmes tij, Kuvendi forcon marrëdhënien me qytetarët dhe krijon një mjedis më të hapur dhe gjithëpërfshirës për debatin dhe vendimmarrjen publike.

Turi realizohet administrativisht pas miratimit me shkrim nga Kryetarja e Kuvendit.

**4. A është ky program gjithëpërfshirës në kuptim të partive parlamentare?**

"Kuvendojmë për Shqipërinë" është një iniciativë e Kryetares së Kuvendit, si një figurë institucionale që garanton funksionimin e Kuvendit përtej palëve dhe anëshmërive politike, me qëllim krijimin e një ure komunikimi të drejtëpërdrejtë me qytetarët dhe grupet e interesit për adresimin e shqetësimeve të tyre në formë të drejtëpërdrejtë, duke shmangur çdo mundësi për polarizim politik.

**5. Të na vendosë në dispozicion të gjitha aktet që provojnë si më sipër**

Bashkëlidhur:

- Plani Strategjik 2020 – 2025, nga Kuvendi i Shqipërisë;
- Rregullorja e Kuvendit;
- Programet e miratuara nga Kryetarja e Kuvendit.

Faleminderit për mirëkuptimin!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Genci GJONÇAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KUVENDI - SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI

# PLANI STRATEGJIK

# I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

# 2020–2025

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE NGA KRYETARI I KUVENDIT

I. HYRJE

II. PROFILI I KUVENDIT

III. VIZIONI

IV. MISIONI

V. VLERAT THEMELORE

VI. FUSHAT PRIORITARE, QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

VII. ZBATIMI DHE MONITORIMI

VIII. SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË KUVENDIT 2020–2025

## PARATHËNIE NGA KRYETARI I KUVENDIT

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 dhe Plani i Veprimit, si dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës i degës legjislative të qeverisjes së Shqipërisë, prezanton vizionin, misionin, vlerat themelore si dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë në përgjigje të sfidave të rëndësishme që qëndrojnë para ligjvënësve shqiptarë dhe para vendit.

Procesi i integrimit europian, përfundimi i reformës zgjedhore, mbështetja e reformës në drejtësi, rritja e produktivitetit dhe modernizimi i ligjbërjes, forcimi i kontrollit parlamentar janë disa nga drejtimet kryesore në të cilat është përqendruar aktualisht veprimtaria e Kuvendit.

Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës, është gjerësisht i përfshirë dhe luan një rol kyç në procesin e integrimit europian. Garantimi i legjitimitetit demokratik, kontrolli ligjor dhe monitorimi politik i procesit të integrimit janë tri kontributet kryesore të ligjvënësve në procesin e integrimit europian.

Vendimi i Këshillit Europian i 26 marsit 2020 për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë përveçse një fitore e madhe politike dhe kombëtare e Shqipërisë është dhe një hap i rëndësishëm i afrimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Europian, i zbutjes së asimetrive politike dhe kulturore të integrimeve europiane dhe i afrimit të kufijve politikë e kulturorë të Europës drejt kufijve gjeografikë e natyrorë të saj.

Por vendimi për çeljen e negociatave përveçse një arritje është dhe një sfidë. Kuvendi, qeveria dhe të gjitha institucionet e Shqipërisë kanë përpara detyra mjaft të rëndësishme, thelbësore e jetike për rrugëtimin tonë europian, të cilat burojnë nga rekomandimet e Këshillit të Bashkimit Europian dhe Bundestagut gjerman.

Kuvendi ka filluar nga puna për zbatimin e tyre dhe jo rastësisht prioritetet e punës së ligjvënësve shqiptarë përputhen me jetësimin e këtyre rekomandimeve.

Reforma zgjedhore, shumica e objektivave të së cilës janë realizuar dhe që do të përfundojë brenda sesionit parlamentar të vjeshtës 2020, do të krijojë kushtet dhe mundësi të barabarta për një garë të ndershme elektorale në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe më tej. Kjo reformë do të kurorëzohet në mënyrë gjithëpërfshirëse me mbështetjen e opozitës parlamentare dhe asaj jashtëparlamentare dhe, çka është më kryesorja, me mbështetjen e shumicës së opinionit publik dhe të qytetarëve shqiptarë.

Kuvendi do të mbështesë me vendosmëri zbatimin dhe progresin e reformës në drejtësi, bërjen funksionale sa më shpejt të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, vazhdimin dhe thellimin e procesit të *vetting*-ut, parandalimin dhe dënimin e shitblerjes së votave, angazhimin e Prokurorisë dhe të Gjykatës Speciale dhe arritjen e rezultateve të dukshme e të matshme në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Kuvendi, komisionet dhe ligjvënësit do të vazhdojnë të prodhojnë ligje cilësore, të cilat do t'i paraprijnë integrimit europian të Shqipërisë, mbështetjes së zhvillimit të ekonomisë dhe rritjes së mirëqenies, sidomos në kushtet e vështirësive që janë krijuar nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e Covid-19.

Qëllimi ynë është që dinamizmi dhe energjitë me të cilat Kuvendi dhe ligjvënësit përballuan e po përballojnë këto fatkeqësi natyrore të shndërrohen në vlera të përhershme dhe të sendërtohen në funksionet e kontributin e të gjitha institucioneve dhe qytetarëve të Shqipërisë.

Forcimi i kontrollit parlamentar ndaj qeverisë dhe monitorimi e mbështetja e institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, si rojë të interesit publik dhe qytetar, do të jenë gjithashtu një prioritet i Kuvendit edhe në vitet që vijnë.

Këto sfida të vështira, por fisnike, pjesë e përgjegjësive dhe kontributit kombëtar të Kuvendit të Shqipërisë, kërkojnë një trupë ligjvënëse energjike e të kulturuar, të përgjegjshme e produktive, të përkushtuar e llogaridhënëse.

Shqipëria ka nevojë për një Kuvend të fortë, përfaqësues, efektiv dhe për njerëzit, të mbështetur në kuitesencën e vlerave tona më të arrira politike, shoqërore, njerëzore e kombëtare.

Këtij qëllimi fisnik i shërben edhe hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Kuvendit, i cili është përcaktuar si një prioritet i Kuvendit edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Europian 2020–2022 dhe si një masë e veçantë në Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2019.

Si dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës, Plani Strategjik ndërthur dhe harmonizon prioritetet e zhvillimit të Kuvendit të Shqipërisë, të trupës ligjvënëse, të strukturave dhe të shërbimeve të Kuvendit në mbështetje të tyre.

Hartimi i këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik për Kuvendin e Shqipërisë është realizuar edhe me kontributin e projektit "Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" (2018–2022), financuar nga qeveria e Konfederatës Zvicerane (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) dhe partnerët zbatues: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Kombëtar Demokrat i SHBA-ve, për të cilët gjej rastin të shpreh vlerësimin e mirënjohjen time dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

**Gramoz Ruçi**

**Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë**

# I. HYRJE

## Përmbledhje ekzekutive

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 përcakton prioritetet e zhvillimit të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2020–2025 për të përmbushur me sukses vizionin dhe misionin e tij si dhe për të arritur standardet më të larta të demokracisë parlamentare.

"Plani strategjik" është konceptuar si një udhërrëfyes që ndërthur vizionin, misionin, vlerat themelore, fushat prioritare, qëllimet strategjike dhe objektivat strategjikë si dhe masat konkrete për përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit në kushtet e një mjedisi veprues që ndryshon vazhdimisht.

Plani Strategjik i Kuvendit është dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës i institucionit që përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit të tij, duke përfshirë deputetët dhe administratën.

Vizioni i Kuvendit është: *Kuvend përfaqësues, efektiv, eficient dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese. Plani Strategjik* e përshkruan deklaratën e misionit të Kuvendit si vijon: *"Ligjbërje cilësore dhe kontroll parlamentar i fortë, pranë qytetarëve, për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin europian të Shqipërisë".*

Në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij Kuvendi i Shqipërisë do të udhëhiqet nga këto vlera themelore: *përfaqësimi, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja, barazia dhe mosdiskriminimi, transparenca, integriteti dhe etika, profesionalizmi dhe kompetenca, paanësia politike.*

Plani Strategjik përcakton katër fusha prioritare të zhvillimit të Kuvendit për periudhën 2020–2025:

1. Efektiviteti i ushtrimit të funksioneve përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës.

2. Roli i Kuvendit në proceset integruese dhe diplomacia parlamentare.
3. Transparenca, pjesëmarrja dhe edukimi qytetar në veprimtarinë e Kuvendit.
4. Kuadri rregullator, burimet njerëzore dhe infrastruktura.

Plani Strategjik përcakton qëllimin strategjik dhe objektivat strategjikë për çdo fushë prioritare.
Qëllimet strategjike sipas fushave prioritare janë:
- rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare;
- forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integrimit europian dhe i diplomacisë parlamentare;
- rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit;
- përmirësimi i kuadrit rregullator, forcimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës.

Plani Strategjik përcakton 19 objektiva strategjikë të Kuvendit për periudhën 2020–2025, nga të cilat 6 objektiva për prioritetin e parë, 4 objektiva për prioritetin e dytë, 4 objektiva për prioritetin e tretë dhe 5 objektiva strategjikë për prioritetin e katërt.

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 shoqërohet nga Plani i Veprimit për zbatimin e tij (Shtojca 1), që përmban aktivitetet konkrete për realizimin e secilit objektiv strategjik, të cilat do të realizohen gjatë periudhës 2020–2025. Për çdo aktivitet të parashikuar në Planin e Veprimit (124 aktivitete) janë përcaktuar treguesit e performancës, struktura përgjegjëse për zbatimin e tij, afati i realizimit dhe efekti financiar shtesë (nëse ka), sipas burimeve të financimit (buxheti i Kuvendit dhe /ose donator). Ndikimi i Planit Strategjik në përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit si dhe progresi drejt arritjes së vizionit të Kuvendit do të varet nga zbatimi i plotë i aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit. Plani i Veprimit do të monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve periodike dhe do të rishikohet çdo vit nga Byroja e Kuvendit me qëllim përshtatjen e tij.

Procesi i hartimit të Planit Strategjik të Kuvendit 2020–2025 është mbështetur nga OSBE-ja dhe NDI-ja në kuadër të projektit "Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar"[1].

**Metodologjia**

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit 2020–2025 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij është bazuar ndër të tjera në:

- Analizën e plotë të mjedisit veprues të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, që ndikon në realizimin e misionit dhe zhvillimin e Kuvendit të Shqipërisë, realizuar me nivelin drejtues politik dhe administrativ të Kuvendit. Është realizuar analiza SWOT, nëpërmjet së cilës u evidentuan pikat e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe rreziqet, të cilat u reflektuan në përcaktimin e fushave prioritare të Planit Strategjik, qëllimit dhe objektivave strategjikë si dhe masave konkrete të konceptuara në planin e veprimit për përmbushjen e objektivave strategjikë.
- Modelin e "*Teorisë së ndryshimit*", e cila përshkruan mënyrën dhe arsyen se pse një ndryshim i dëshiruar pritet të ndodhë në një kontekst të caktuar[2].
- Dokumente strategjike kombëtare (*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020)* dhe sektoriale (*Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2020–2022*).

[1] Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik është një nga prioritetet bazë të Kuvendit, adresuar në rezultatet kryesore të projektit 4-vjeçar "Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar", që financohet nga qeveria e Konfederatës Zvicerane. Përfituesit kryesorë të këtij projekti janë Kuvendi i Shqipërisë dhe qytetarët shqiptarë. Partnerët zbatues të projektit janë organizata ndërqeveritare OSBE (Prezenca në Shqipëri) dhe organizata jofitimprurëse NDI.
[2] Carol Weiss, 1995; https://www.theoryofchange.org/what-is-theory-of-change/how-does-theory-of-change-work/

- Angazhimet dhe standardet ndërkombëtare lidhur me funksionimin e parlamenteve kombëtare[3] si dhe angazhimet dhe detyrimet që burojnë direkt për Kuvendin nga aktet dhe raportet e monitorimit të organizmave ndërkombëtarë ku Shqipëria është palë[4].
- Konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna për Kuvendin në aktet e institucioneve të BE-së për Shqipërinë[5], në aktet e strukturave të përbashkëta BE–Shqipëri[6] si dhe në raportet e ekspertëve të BE-së në kuadër të zbatimit të projektit të binjakëzimit *"Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e pranimit në BE"* (IPA 2014).
- Marrjen e ekspertizës vendase dhe ndërkombëtare me ekspertë nga parlamenti austriak, parlamenti grek, parlamenti danez (me mbështetjen e OSBE-së), Bundestagu gjerman, parlamenti slloven, parlamenti kroat dhe eksperti i NDI-së për Institutin Parlamentar. Ekspertiza vendase dhe ndërkombëtare mundësoi zbatimin e standardeve më të përparuara europiane për hartimin e një dokumenti strategjik për parlamentet.
- Transparencën, gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e pjesëmarrësve në proces, duke filluar nga Sekretari i Përgjithshëm, deputetët, kabineti i Kryetarit të Kuvendit, drejtuesit, punonjësit, konsulentët, grupet e interesit që bashkëpunojnë me Kuvendin të përfshirë direkt apo indirekt në Planin Strategjik.
- Konsultimin e brendshëm, që përfshiu të gjithë deputetët dhe administratën e Kuvendit (stafin civil dhe politik) dhe u realizua përmes disa tryezave të përbashkëta si dhe pyetësorit për këtë qëllim.
- Konsultimin e jashtëm, i cili konsistoi në konsultimin publik të Projektplanit Strategjik, përmes publikimit të tij *online* gjatë periudhës mars–maj 2020 si dhe sesionet e konsultimit të jashtëm me aktorët e jashtëm: organizatat e shoqërisë civile që bashkëpunojnë me Kuvendin, medien, institucionet e pavarura; ish-deputetët e Kuvendit me përvojë të gjatë legjislative si dhe me grupe të të rinjve[7].
- Qasjen gjinore të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij, duke reflektuar parimet europiane të integrimit gjinor si dhe duke e harmonizuar me programin e veprimit "Për një parlament të ndjeshëm gjinor", si dokumentin kuadër që do të udhëheqë punën e Kuvendit në aspektin e integrimit dhe barazisë gjinore.

## II. PROFILI I KUVENDIT

Viti 2020 përkon me 100-vjetorin e parlamentarizmit shqiptar. Historia e parlamentarizmit shqiptar fillon më 21 janar 1920 me mbajtjen e Kongresit të Lushnjës dhe zgjedhjen e Këshillit

---

[3] Standardet lidhur me funksionimin e parlamenteve të vendosura nga Unioni Ndërparlamentar (IPU), https://www.ipu.org/our-impact/strong-parliaments/setting-standards .
[4] Raportet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri; raportet e GRECO-s për Shqipërinë; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC); Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara; raportet e SIGMA-s etj.
[5] Raportet vjetore të Komisionit Europian për Shqipërinë; rezolutat e Parlamentit Europian për Shqipërinë; konkluzionet e Këshillit të Ministrave të BE-së dhe të Këshillit Europian, relevante për Shqipërinë.
[6] Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri; Komiteti i Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri; nënkomitet e Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri.
[7] Komentet dhe sugjerimet e mbledhura nga procesi i konsultimit iu nënshtruan vlerësimit të grupit të punës dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre gjetën reflektim në Planin Strategjik dhe në Planin e Veprimit për zbatimin e tij, duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm të këtyre dy dokumenteve.

Kombëtar. Zgjedhjet e para pluraliste pas rënies së sistemit totalitar u zhvilluan më 31 mars të vitit 1991.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Shqipëria është shtet unitar dhe republikë parlamentare. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit, që e ushtron në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij në Kuvend.

Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë. Si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin shqiptar, Kuvendi është organi më i lartë legjislativ që miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Kuvendi ushtron funksionin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit dhe monitoron institucionet e pavarura.

Kuvendi garanton interesat e të gjitha grupeve shoqërore në vendimmarrjen që realizohet përmes dialogut politik dhe kompromisit. Kuvendi në mënyrë të vazhdueshme ka rritur nivelin e përfaqësimit ndaj elektoratit dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve duke qenë i hapur dhe transparent.

Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese, organizative, koordinuese dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij.

## III. VIZIONI

Vizioni përshkruan synimin për të ardhmen e Kuvendit të Shqipërisë dhe shpreh gatishmërinë se të gjitha veprimet duhet të zhvillohen në kuadër të arritjes së këtij vizioni. Vizioni i Kuvendit të Shqipërisë është:

***"Kuvend përfaqësues, efektiv, eficient dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese."***

## IV. MISIONI

Me qëllim përmbushjen e vizionit, deklarata e misionit të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2020–2025 është:

***"Ligjbërje cilësore dhe kontroll parlamentar i fortë, pranë qytetarëve për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin europian të Shqipërisë."***

## V. VLERAT THEMELORE

Në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij Kuvendi i Shqipërisë udhëhiqet nga këto vlera themelore:

- *përfaqësimi;*
- *kushtetutshmëria dhe ligjshmëria;*
- *llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja;*
- *barazia dhe mosdiskriminimi;*
- *transparenca;*
- *integriteti dhe etika;*
- *profesionalizmi dhe kompetenca,*

*- paanësia politike*[8].

## VI. FUSHAT PRIORITARE, QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

**PRIORITETI I: Efektiviteti i ushtrimit të funksioneve përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës**

Kuvendi i Shqipërisë gjatë ushtrimit të funksioneve të përcaktuara në Kushtetutë është përballur me pengesa dhe vështirësi që duhen adresuar. Në ushtrim të funksionit ligjvënës duhet përmirësuar cilësia e projektligjeve të propozuara, duhet rritur numri i nismave të deputetëve dhe nismave nga zgjedhësit, si dhe duhet siguruar respektimi më i mirë i rregullave procedurale. Kontributi real i shoqërisë civile dhe i grupeve të interesit në procesin legjislativ duhet rritur.
Ushtrimi i kontrollit parlamentar me të gjitha mekanizmat e tij duhet përmirësuar në disa aspekte. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet kontrollit për zbatimin e ligjeve. Deputetët duhet të ndërgjegjësohen për përdorimin cilësor dhe sasior të këtyre mekanizmave. Në funksion të ushtrimit të kontrollit mbështetja e vazhdueshme nga Kuvendi ndaj institucioneve të pavarura është vlerësuar e domosdoshme, me qëllim rritjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të tyre nga ekzekutivi.
Në ushtrim të funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies duhet forcuar lidhja e deputetëve me zgjedhësit nëpërmjet vënies në eficiencë të plotë të zyrave të deputetëve në qarqe dhe përdorimit të mjeteve dhe mënyrave të tjera të komunikimit.
Ndërveprimi i platformave elektronike ekzistuese dhe integrimi i tyre në nivel institucional dhe ndërinstitucional do t'i shërbejë unifikimit të standardeve në funksion të procesit ligjvënës.

**Qëllimi strategjik: Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare**

**Objektivat strategjikë:**

*1. Përmirësimi i punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare dhe seancat plenare, duke përfshirë aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.*
*2. Përmirësimi i mekanizmave dhe praktikave të mbikëqyrjes parlamentare*
*3. Forcimi i bashkëpunimit Kuvend–qeveri, Kuvend–shoqëri civile dhe grupe interesi.*
*4. Zbatimi efektiv i mekanizmit ndërinstitucional Kuvend–institucione të pavarura–ekzekutiv.*
*5. Përmirësimi i ndërveprimit deputet–qytetar në ushtrimin e funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve.*
*6. Përdorimi me efikasitet i teknologjisë së informacionit në përmirësimin e funksioneve të Kuvendit dhe punën në distancë.*

---

[8] Neni 2, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës parashikojnë: " *1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. 2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti*".
Neni 70, pika 1 e Kushtetutës parashikon: *"Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues"*.
Neni 107, pika 1 e Kushtetutës parashikon: *"Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit"*.
Neni 5 i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar" parashikon: *"Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil"*.

**PRIORITETI II: Roli i Kuvendit në proceset integruese dhe diplomacinë parlamentare**

Kuvendi i Shqipërisë luan një rol thelbësor në procesin e integrimit europian të vendit, duke i garantuar procesit legjitimitetin e nevojshëm demokratik si dhe kontrollin ligjor dhe politik.
Konsolidimi i mëtejshëm i demokracisë dhe parlamentarizmit në Shqipëri si dhe sfidat e reja me të cilat do të përballet Kuvendi pas hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në, e bëjnë të domosdoshëm përmirësimin e mëtejshëm të rolit të tij në procesin e integrimit europian, me qëllim monitorimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, nga procesi i negociatave dhe i pranimit në BE.
Kuvendi përmes diplomacisë parlamentare luan rol të rëndësishëm në forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me shtetet e tjera, dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke kontribuar në rritjen e mirëkuptimit dhe forcimin e bashkëpunimit reciprok mes shteteve. Kuvendi do të forcojë më tej bashkëpunimin me Parlamentin Europian dhe parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, me qëllim promovimin e procesit të integrimit europian të vendit.

**Qëllimi strategjik: Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integrimit europian dhe i diplomacisë parlamentare.**

**Objektivat strategjikë:**

*1. Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Integrimit Europian dhe Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian.*
*2. Forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit për kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve me acquis të BE-së.*
*3. Rritja e efektivitetit të monitorimit nga Kuvendi për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integrimit europian të Shqipërisë.*
*4. Rritja e efektivitetit të diplomacisë parlamentare në funksion të integrimit europian dhe zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe me parlamentet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.*

**PRIORITETI III: Transparenca, pjesëmarrja dhe edukimi qytetar në veprimtarinë e Kuvendit**

Kuvendi i Shqipërisë u siguron qytetarëve të drejtën e informimit dhe pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e tij sipas legjislacionit në fuqi. Instrumentet që përdor Kuvendi në funksion të transparencës institucionale duhen përmirësuar në vazhdimësi.
Kuvendi duhet të rishikojë "Strategjinë e komunikimit" dhe të sigurojë monitorimin e zbatimit të saj në funksion të transparencës dhe edukimit qytetar. Kjo Strategji duhet të përmbajë politika për përmirësimin e marrëdhënies së Kuvendit me medien. Në mënyrë të veçantë faqja zyrtare e internetit duhet të jetë lehtësisht e përdorshme dhe informacioni të pasqyrohet në mënyrën e duhur për publikun e gjerë, me qëllim arritjen e një parlamenti digjital dhe të hapur.
Kuvendi zhvillon aktivitete mbi edukimin qytetar, që duhet të jenë të mirëplanifikuara, të strukturuara dhe në përputhje me interesin e publikut. Për këtë arsye Kuvendi duhet të punojë për harmonizimin e standardizimit të formave të edukimit qytetar me format e reja dhe krijuese.

Kuvendi duhet të krijojë lehtësitë e nevojshme për të pasqyruar kontributin e shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit që dëshirojnë të jenë pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje.

**Qëllimi strategjik: Rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit.**

**Objektivat strategjikë:**

*1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare.*
*2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e parlamentit.*
*3. Promovimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse me anë të teknologjisë së informacionit.*
*4. Përmirësimi i marrëdhënieve me medien për pasqyrimin real të veprimtarisë së Kuvendit.*

**PRIORITETI IV: Kuadri rregullator, burimet njerëzore dhe infrastruktura e Kuvendit**

Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duhet të ketë pavarësi të plotë organizative, funksionale e financiare. Në këtë aspekt sigurimi i pavarësisë financiare kërkon rishikimin e kuadrit ligjor.
Modernizimi i shërbimeve të Kuvendit për t'u përballuar me nevojat dhe sfidat e reja të kohës sjell domosdoshmërinë e reformimit të strukturës së shërbimeve, hartimit të një strategjie për zhvillimin e burimeve njerëzore si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm.
Nevoja e një standardi bashkëkohor të kërkimit parlamentar, bibliotekës dhe edukimit qytetar sjell domosdoshmërinë e krijimit të Institutit Parlamentar.

Hapësirat e pamjaftueshme për deputetët dhe administratën dhe zhvillimi i veprimtarisë parlamentare në dy godina të ndryshme sjellin pengesa dhe vështirësi logjistike në zhvillimin e veprimtarisë normale të Kuvendit. Në këto kushte, lind nevoja për projektimin dhe ndërtimin e një godine të re, e cila do të ketë edhe sallën e re të seancave plenare.

**Qëllimi strategjik: Përmirësimi i kuadrit rregullator, forcimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës.**

**Objektivat strategjikë:**

*1. Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Kuvendit.*
*2. Rritja e kapaciteteve të administratës në përputhje me sfidat dhe kërkesat e reja.*
*3. Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës.*
*4. Rritja e efektivitetit dhe paanshmërisë në ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe edukuese nëpërmjet Institutit Parlamentar.*
*5. Përmirësimi i hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës me standarde të larta.*

## VII. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 është një proces në vazhdimësi, i cili duhet të monitorohet, të vlerësohet dhe, nëse është e nevojshme, të rishikohet me qëllim për ta përshtatur me zhvillimet e reja si dhe për të siguruar eficiencën dhe qëndrueshmërinë e tij.
Plani Strategjik i Kuvendit shoqërohet nga Plani i Veprimit për zbatimin e tij (Shtojca 1), që përmban aktivitetet konkrete për realizimin e secilit objektiv strategjik, të cilat do të realizohen gjatë periudhës 2020–2025. Për çdo aktivitet të parashikuar në Planin e Veprimit (124 aktivitete) janë përcaktuar treguesit e performancës, struktura përgjegjëse për zbatimin e tij, afati i realizimit dhe efekti financiar shtesë (nëse ka), sipas burimeve të financimit (buxheti i Kuvendit dhe/ose donatorët/partnerët).
Ndikimi i Planit Strategjik në përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit si dhe progresi drejt arritjes së vizionit të Kuvendit do të varet nga zbatimi i plotë i aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit. Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit do të monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve vjetore që Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit do t'i dërgojë Byrosë së Kuvendit.
Plani i Veprimit do të vlerësohet dhe rishikohet çdo vit për ta përshtatur me zhvillimet e reja. Rishikimi i Planit të Veprimit do të bëhet mbi bazën e raporteve vjetore për zbatimin e tij, të cilat do të shërbejnë si burimi kryesor i të dhënave për vlerësimin dhe rishikimin e Planit të Veprimit.

# VIII. SHTOJCA 1:
# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË KUVENDIT 2020–2025

## FUSHA PRIORITARE I:
## EFEKTIVITETI I USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE PËRFAQËSUES, LEGJISLATIV DHE MBIKËQYRËS

**Qëllimi strategjik:**
**Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare**

| Aktivitetet | Treguesit | Struktura përgjegjëse | Afati kohor | Efekti financiar shtesë |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik I:** **Përmirësimi i punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare, në seancë plenare, duke përfshirë aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.** | | | | |
| I.1.1 Workshop dhe sesione informimi me deputët për:<br>a) procesin legjislativ në komisione dhe seancë;<br>b) njohjen e deputetëve me procedurat parlamentare;<br>c) promovimin e praktikave më të mira parlamentare (precedentët);<br>ç) asistencën për hartimin (konsultimin) e nismave ligjvënëse të deputetëve;<br>d) njohjen e deputetëve me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, për kontrollin abstrakt të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. | Zhvillimi i 5 *workshop*-eve/ sesioneve të informimit | Shërbimi Legjislativ | 2021–2023 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.1.2 Hartimi dhe miratimi i manualit për veprimtarinë e komisioneve/ nënkomisioneve. | Manuali i hartuar dhe i miratuar | Grup pune nga Shërbimi Legjislativ;<br>Miratimi: Byroja e | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Kuvendit | | Donatori/partneri |
| I.1.3 Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit:<br>a) duke caktuar afatin e miratimit të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme për çdo organ drejtues të Kuvendit (Byroja e Kuvendit; sekretariatet e Kuvendit, Konferenca e Kryetareve dhe këshillat) si dhe procedurën përkatëse;<br>b) duke rishikuar nenin 67, që ndalon perdorimin e telefonave të levizshëm nga deputetët gjatë zhvillimit të mbledhjeve në komisione dhe në seancë plenare (aplikacioni mobile). | Ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të hartuara dhe të miratuara. | Grup pune nga Shërbimi Legjislativ;<br>Miratimi: seanca plenare. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet |
| I.1.4 Zbatimi i Programit të Veprimit për Parlamentin e Ndjeshëm Gjinor për aktivitetet që lidhen me prioritetin "Legjislacioni i ndjeshëm gjinor". | Zbatimi i të gjitha aktiviteteve të Programit të Veprimit | Grup pune;<br>stafi që mbështet Aleancën dhe Nënkomisionin për Çështjet Gjinore. | 2020–2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri. |
| I.1.5 Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese për çështjet me ndjeshmëri gjinore për deputetët sipas Programit të Veprimit për Parlamentin e Ndjeshëm Gjinor. | Zhvillimi i trajnimeve të parashikuara | Grup pune;<br>stafi që mbështet Aleancën dhe Nënkomisionin për Çështjet Gjinore. | 2020–2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.1.6 Organizimi i aktiviteteve specifike njohëse për deputetët sipas fushave të përgjegjësisë të komisioneve dhe nën komisioneve. | Zhivillimi i 12 aktiviteteve | Shërbimi Legjislativ;<br>Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve (SHMI) | 2021–2024 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.1.7 Zhvillimi i konferencës shkencore ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të rregullores së parë të Kuvendit të Shqipërisë si dhe publikimi i punimeve të prezantuara në këtë konferencë. | Zhvillimi i konferencës | INDOK | 2020 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| ***Objektivi strategjik 2:***<br>***Përmirësimi i mekanizmave dhe praktikave të mbikëqyrjes parlamentare.*** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I.2.1 Organizimi i *workshop*-eve dhe sesioneve të informimit për orientimin e deputetëve në përdorimin efektiv dhe eficent të instrumenteve të kontrollit parlamentar si:<br>a) seancat dëgjimore;<br>b) vizitat monitoruese në terren;<br>c) interpelancat dhe pyetjet;<br>ç) mocionet me debat;<br>d) kërkesat për informacion. | Zhvillimi i 2 deri 3 *workshop*-eve në vit. | SHMI;<br>Shërbimi Legjislativ. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.2.2 Hartimi dhe miratimi i udhëzuesit të praktikave të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar. | Manuali i hartuar dhe i miratuar. | Grupi i punës;<br>Konferenca e Kryetar`ve;<br>Kuvendi/Seancë plenare. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.2.3 Përgatitja e kalendarit të kontrollit parlamentar të Kuvendit (axhenda vjetore për kontrollin e mbikëqyrjen parlamentare për institucionet e pavarura dhe agjencitë ligjzbatuese). | Kalendari i përgatitur (çdo fillim sesioni). | Grupi i punës;<br>SHMI;<br>Konferenca e Kryetarëve. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.2.4 Zhvillimi i analizave të ndikimit të legjislacionit *(ex-post evaluation/ post legislative scrutiny)* për ligjet e miratuara nga Kuvendi sipas fushave të përgjegjësisë të komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare. | Përfundimi i analizës dhe hartimi i raportit. | Sherbimet e Kuvendit. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.2.5 Trajnim i deputetëve dhe i stafit për shqyrtimin e ndikimit të legjislacionit (*post legislative scrutiny)* lidhur me zbatimin e këtij instrumenti të kontrollit parlamentar. | Përfundimi i trajnimit (4 *workshop*-e). | Grup pune | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.2.6 Zbatimi i Programit të Veprimit për Parlamentin e Ndjeshëm Gjinor për aktivitetet që lidhen me kontrollin parlamentar. | Zbatimi i aktivitetetve sipas Programit të Veprimit. | Grupi i punës;<br>Nënkomisioni për Çështjet Gjinore;<br>Aleanca e Grave Deputete. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| I.2.7 Workshop-e për trajnim të avancuar të Shërbimit të Monitorimit dhe kërkimit parlamentar. | Zhvillimi i *workshop*-eve (2 *workshop*-e). | SHMI;<br>Shërbimi i Kërkimit Parlamentar. | 2020-2022 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| **Objektivi strategjik 3:**<br>***Rritja e bashkëpunimit Kuvend–qeveri, Kuvend–shoqëri civile dhe grupe interesi*** | | | | |
| I.3.1 Përgatitja nga Kuvendi e kalendarit vjetor legjislativ bazuar në programin analitik legjislativ të Këshillit të Ministrave si dhe në nismat ligjore të deputetëve. | Hartimi i kalendarit. (Periodikisht/ vjetor). | Shërbimi Legjislativ | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.3.2 Workshop me përfaqësues të Këshillit të Ministrave për koordinimin e axhendës legjislative dhe respektimin e kërkesave të Rregullores së Kuvendit për përmbajtjen e relacioneve shoqëruese të projektligjeve (relacioni, raporti i vlerësimit të ndikimit, tabelat e përputhshmërisë, tabela e konsultimit publik). | Zhvillimi i *workshop*-it (1 herë në vit). | Shërbimi Legjislativ;<br>SHMI. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.3.3 Zhvillimi i një programi trajnimi dhe i sesioneve të trajnimit me grupet e interesit dhe me OSHC-të që bashkëpunojnë me Kuvendin për procesin ligjvënës, procesin e konsultimit dhe dëgjesat publike. | Zhvillimi i programit të trajnimit (1 herë në vit). | Shëbimi i Komisioneve. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.3.4 Rishkimi i manualit të pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit. | Manuali i rishikuar | Grupi i punës;<br>shëbimet e Kuvendit.<br>Miraton: Byroja e Kuvendit. | 2020-2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| ***Objektivi strategjik 4:***<br>***Zbatimi efektiv i Mekanizmit Ndërinstitucional Kuvend–institucione të pavarura–ekzekutiv.*** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I.4.1 Organizimi i takimeve periodike Kuvend–institucione të pavarura–ek zekutiv për zbatimin dhe përditësimin me efektivitet të platformës ndërinstitucionale *online* për rekomandimet e institucioneve të pavarura ndaj ekzekutivit si dhe rritjen e transparencës së tyre. | Zhvillimi i 2 takimeve vjetore. | SHMI. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.4.2 Krijimi në Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit të një hapësire për rekomandimet e raportit vjetor të Komisionit Europian për Shqipërinë, adresuar institucioneve të pavarura. | Publikimi i rekomandimeve në platforme. | SHMI;<br>Shërbimi i IT-së. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.4.3 Përfshirja në Platformën Ndërinstitucionale e rezolutave të Kuvendit lidhur me institucionet e pavarura. | Publikimi i rezolutave në platformë. | SHMI;<br>Shërbimi i IT-së. | 2020–2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.4.4 Ngritja e Nënkomisionit për Monitorimin e Veprimtarisë dhe Ndjekjen e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. | Krijimi i Nënkomisionit | Komisioni i Ekonomisë;<br>Konferenca e Kryetarëve;<br>SHMI. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| ***Objektivi strategjik 5:***<br>***Përmirësimi i ndërveprimit deputet–qytetar në ushtrimin e funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve.*** | | | | |
| I.5.1 Vënia në funksion të plotë e 24 zyrave zgjedhore të deputetëve në 12 qarqet e vendit. | Vendosja në funksion të plotë e 24 zyrave rajonale. | Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe i Trajtimit të Deputetëve (SHBNJTD). | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Njesite Vendore. |
| I.5.2 Hartimi i planit vjetor të përbashkët aktivitetesh ndërmjet grupeve parlamentare, administratës së Kuvendit dhe stafit të zyrave zgjedhore në koodinim me grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile vendore. | Plani vjetor i hartuar. | Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe i Trajtimit të Deputetëve;<br>stafi politik. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.5.3 Hartimi i planit të aktiviteteve për deputetët dhe stafin për zbatimin e *Javës së Gjelbër* (neni 40/1 i Rregullores). | Plani i aktiviteteve i hartuar. | Stafi politik. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I.5.4 Zbatimi i Programit të Veprimit për Parlamentin e Ndjeshëm Gjinor për aktivitetet që lidhen me përfaqësimin. | Zbatimi i aktiviteteve. | Grupi i punës; Nënkomisioni për çështjet gjinore; Aleanca e Grave Deputete. | 2021–2025 | Kuvendi- Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.5.5 Organizimi i takimeve periodike të deputetëve me drejtuesit vendorë të zonave që ata mbulojnë dhe me zgjedhësit për problematikat që ata kanë (kalendar takimesh që ndiqet nga zyra zgjedhore e deputetit). | Organizimi i takimeve. | Stafi politik; SHBNJTD. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.5.6 Vendosja e *numrave të gjelbër* që të lidhë drejtpërdrejt qytetarin me zyrën zgjedhore të deputetit për të lehtësuar komunikimin. | Instalimi i linjës së gjelbër telefonike. | SHBNJTD | 2022 | **Kuvendi- Kosto shtesë në buxhet: <u>576, 000 lekë në vit.</u>** |
| **Objektivi strategjik 6:<br>Përdorim më eficient i teknologjisë së informacionit në përmirësimin e funksioneve të Kuvendit dhe për punën në distancë.** | | | | |
| I.6.1 Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT). | Strategjia e hartuar dhe e miratuar. | Byroja e Kuvendit; STTI; Sherbimi i IT/Konsulence. | Mars 2021 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.2 Analiza e strukturës së dokumenteve parlamentare nga pikëpamja IT, në funksion të përmirësimit të transparecës dhe qëndrueshmërisë. | Raporti i miratuar. | Sherbimi i IT/Konsulence. | 2020 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.3 Krijimi i ciklit të punës (*workflow*) të dokumenteve të procesit ligjbërës. | Raporti i miratuar. | STTI; Shërbimi i IT-së/konsulencë | 2020-2021 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.4 Analizimi dhe përcaktimi i *metadata*-ve dhe gjetja e rregullsisë e strukturës së dokumentit. | Raporti i miratuar. | Byroja e Kuvendit; STTI; Shërbimi i IT- | 2020-2021 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | së/konsulencë. | | kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.5 Vënia në zbatim i Editorit XML. | Raport i miratuar. | Sh`rbimi i IT-së/konsulencë. | 2021 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.6 Digjitalizimi i arkivës së dokumenteve parlamentare. | Projekt per digjitalizimin. | Byroja e Kuvendit;<br>Shërbimet e Kuvendit. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br><br>Donatori/partneri |
| I.6.7 Implementimi i infastrukturës *Virtual Desktop Infastructure* (VDI). | Infrastruktura e ngritur. | Shërbimi i IT-së | 2020-2021 | **Kuvendi - Kosto shtesë në buxhet: <u>25,000,000 lekë</u>.**<br><br>Donatori/partneri |
| I.6.8 Krijimi i *repository* (magazinë dokumentesh):<br>a) zhvillimi i sistemit të menaxhimit të kërkimit;<br>b) zhvillimi i sistemit të menaxhimit të bibliotekës. | Arkiv i ri.<br>Sisteme të përfunduara dhe funksionale. | Firma e kontraktuar;<br>Shërbimi i Kërkimit dhe i Bibliotekës;<br>Shërbimi i IT-së. | 2021 | Donatori/partneri.<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| I.6.9 Modernizimi i bibliotekës përmes:<br>a) Vënies në dispozicion të database-ve bashkëkohore, që kanë të përfshirë formatin e përditësuar të Eurovoc-ut;<br>b) Abonimit në baza të dhënash, revistash shkencore (juridike etj.) dhe librave në fusha të ndryshme vendase dhe të huaja;<br>c) Kodifikimit të librave, pajisjeve skanuese për kodet e librave;<br>ç) Indeksimi i unifikuar i dokumentacionit dhe librave. | a) Databaza me Eurovoc të përditësuar e të disponueshme.<br><br>b) Abonime në revista, baza të dhënash, biblioteka *online*, blerje e librit shqip.<br><br>c) Pajisjet janë të disponueshme dhe | Shërbimi i Kërkimit dhe i Bibliotekës;<br><br>Shërbimi i IT.<br><br>Shërbime të tjera për abonimin në revista, biblioteka *online*. | a) 2020<br>b) 2020–2025<br>c) 2021-2022<br>ç) 2021-2022 | Donatori/partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | procesi i kodifikimit i përfunduar.<br>ç) procesi i indeksimit i përfunduar. | | | |

| **FUSHA PRIORITARE II<br>ROLI I KUVENDIT NË PROCESET INTEGRUESE DHE DIPLOMACIA PARLAMENTARE** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi strategjik:<br>Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integrimit europian dhe i diplomacisë parlamentare.** | | | | |
| **Aktivitetet** | **Treguesit** | **Struktura përgjegjëse** | **Afati kohor** | **Efekti financiar shtesë** |
| **Objektivi strategjik 1:<br>*Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Integrimit Europian dhe Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian*** | | | | |
| II.1.1 Hartimi nga KIE në fillim të çdo viti i planit vjetor për shqyrtimin *ex-post* të legjislacionit të përafruar me *acquis* të BE-së si dhe miratimi i raporteve të shqyrtimit *ex-post* të legjislacionit të përafruar, sipas nenit 103/ 3 të Rregullores së Kuvendit. | Plani vjetor për shqyrtimin *ex-post* të legjislacionit të përafruar i hartuar.<br><br>Numri i raporteve të shqyrtimit *ex-post* të legjislacionit të përafruar, të miratuara gjatë një viti. | KIE;<br>komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit;<br>Konferenca e Kryetarëve;<br>shërbimet e Kuvendit. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.1.2 Rishikimi i ligjit 15/2015 për të parashikuar një mekanizëm/ model efektiv të mbikëqyrjes së veprimtarisë së qeverisë (rishikimin e pozicionit negociues), në reflektim të mbështetjes së procesit të negociatave të anëtarësimit, bazuar në praktikat më të mira në këtë fushë. | Amendimet e ligjit 15/2015, të hartuara dhe miratuara. | KÇLAPDNJ;<br>KIE/ KKIE.<br>Kuvendi/ seancë plenare; shërbimet e Kuvendit. | 2021–2022 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.1.3 Organizimi i takimeve periodike dhe atyre ndërgjegjësuese sipas parashikimit në Rregulloren e KKIE-së për garantimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e integrimit europian. | Numri i takimeve periodike të organizuara nga KKIE me aktorët e përfshirë në procesin e integrimit europian. | KKIE;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.1.4 Hartimi i programit vjetor të punës të KKIE-së për vitet 2020–2025 sipas nenit 11 të Rregullores së KKIE-së. | Programit Vjetor i Punës të KKIE, i hartuar brenda datës 31 mars të çdo viti. | KKIE;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.1.5 Organizimi periodik i Shkollës së Integrimit Europian. | 1 Shkollë e Integrimit Europian në vit. | KKIE;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| II.1.6 Organizimi i takimeve të anëtarëve të KKIE-së me homologët e tyre nga vendet e rajonit për procesin e negociatave. | Numri i takimeve të organizura. | KKIE;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së;<br>SHMJ. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.1.7 Organizimi i takimeve dhe/ose pjesëmarrje aktive e KIE-së në takimet periodike të COSAC/COSAP. | Numri i takimeve periodike të COSAC/ COSAP që KIE merr pjesë. | KIE;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>SHMJ. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.1.8 Organizimi i takimeve nga KIE dhe KKIE me të rinj për rritjen e ndërgjegjësimit e tyre për rolin që ata kanë në procesin e integrimit evropian. | Numri i takimeve që KIE dhe KKIE organizojnë me të rinj. | KIE;<br>KKIE<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| **Objektivi strategjik 2:**<br>**Forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit për kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve me *acquis* të BE-së.** | | | | |
| II.2.1 Monitorimi efektiv i përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara në Kuvend me *aquis* të Bashkimit Europian për të garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar. | Numri i projektligjeve me përafrim që miratohen gjatë një viti.<br>Numri i amendamenteve që KIE paraqet për ligjet me përafrim gjatë një viti. | KIE;<br>Komisionet e tjera të Përhershme të Kuvendit;<br>SHPL.<br>Shërbimi i Komisioneve. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.2.2 Aktivizimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i *database*-it parlamentar për ligjet me përafrim të miratuara nga Kuvendi që nga hyrja në fuqi e MSA-së (1 prill 2009) dhe në vijim. | Shpeshtësia e përditësimeve të databazës gjatë një viti. | SHPL;<br>Shërbimi i IT-së. | 2020–2025 | Kuvendi Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.2.3 Pasurimi periodik i fondit të bibliotekës së Kuvendit me literaturë në fushën e së drejtës dhe politikave të BE-së. | Numri i librave të blerë gjatë një viti. | SHPL;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së;<br>Shërbimi i Kërkimit Parlamentar. | 2020–2025 | **Kuvendi - Kosto shtesë në buxhet: 1,800,000 lekë në vit.**<br><br>Donatori/partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.2.4 Kryerja e abonimeve elektronike-online *(e-abonime)* për krijimin e librarisë elektronike *(e-library)*. | Numri i abonimeve elektronike-online (e-abonime). | SHPL;<br>Sekretariati Teknik i KKIE;<br>Shërbimi i Kërkimit Parlamentar. | 2020–2025 | Donator/partneri<br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.2.5 *Workshop-e*/ sesione informimi me deputetët për legjislacionin dhe politikat e BE-së dhe njohuri mbi gjuhën angleze dhe terminologjinë e përdorur në këtë fushë. | Numri i sesioneve të informimit me deputetët KIE. | Deputetët e KIE. | 2020–2025 | **Kuvendi - Kosto shtesë në buxhet:** **600,000 lekë në vit.**<br>Donatori/partneri |
| **Objektivi strategjik 3:**<br>***Rritja e efektivitetit të monitorimit nga Kuvendi për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integrimit europian të Shqipërisë.*** | | | | |
| II.3.1 Përdorimi më i shpeshtë dhe cilësor i instrumenteve të kontrollit parlamentar për monitorimin e reformave dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integrimit europian. | Shpeshtësia e përdorimit të instrumenteve të kontrollit parlamentar nga KIE-ja. | Deputetët;<br>KIE;<br>Komisionet e tjera parlamentare;<br>Kuvendi/ seancë plenare;<br>Shërbimi i Komisioneve:<br>Shërbimi i Seancës Plenare. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.3.2 Mbikëqyrja e planifikuar e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Europian për periudhën 2020–2025. | Shpeshtësia dhe efektiviteti i përdorimit të instrumenteve të kontrollit parlamentar nga KIE-ja dhe KKIE-ja për të mbikëqyrur zbatimin e PKIE. | KIE;<br>KKIE;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>Sekretariati Teknik i KKIE-së. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.3.3 Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të raporteve vjetore të Komisionit Europian për Shqipërinë që do të publikohen gjatë viteve 2020–2025. | Shpeshtësia e kontrollit parlamentar nga KIE dhe KKIE për të mbikëqyrur zbatimin e rekomandimeve të raporteve vjetore të KE-së. | KIE;<br>KKIE;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>Sekretariati Teknik i KKIE. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.3.4 Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në raportet vjetore të KE-së për Shqipërinë si dhe monitorimi i zbatimit të tij. | Plani i Veprimit të Kuvendit i hartuar dhe miratuar.<br>Numri raportimeve periodike për zbatimin e Planit të Veprimit. | Konferenca e Kryetarëve;<br>Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit;<br>Shërbimet e Kuvendit. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.3.5 Monitorimi i kuadrit të përgjithshëm të bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë në BE përmes mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit përkatës rregullator (pas hapjes së negociatave). | Shpeshtësia e përdorimit të instrumenteve të kontrollit parlamentar për të mbikëqyrur bisedimet e anëtarësimit. | KIE;<br>Komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit;<br>KKIE;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>Sekretariaiti Teknik i KKIE;<br>SHPL. | Pas hapjes zyrtare të negociatave e në vazhdim. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.3.6 Zhvillimi i takimeve periodike me drejtuesit e grupit negociator dhe të delegacionit shtetëror në bisedimet për anëtarësim në BE (pas hapjes së negociatave). | Numri i takimeve periodike të zhvilluara me drejtuesit e grupit negociator. | KKIE;<br>KIE;<br>Sekretariati Teknik i KKIE;<br>Shërbimi i Komisioneve. | Pas hapjes zyrtare të negociatave e në vazhdim. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.3.7 Publikimi periodik online i *Newsletter*-it të Kuvendit lidhur me veprimtarinë e Kuvendit në procesin e integrimit europian. | 4 Newsletter-a në vit. | SHPL;<br>Sekretariati Teknik i KKIE;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>Shërbimi i Seancave Plenare;<br>Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| **Objektivi strategjik 4:<br>Rritja e efektivitetit të diplomacisë parlamentare në funksion të integrimit evropian dhe zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe me parlamentet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.** | | | | |
| II.4.1 Zhvillimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërparlamentare përmes aktiviteteve të Kryetarit të Kuvendit. | Numri i aktiviteteve të Kryetarit të Kuvendit në kuadër të marrëdhënieve me jashtë. | Kryetari i Kuvendit;<br>Kabineti i Kryetarit te Kuvendit;<br>SHMJ. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.4.2 Zhvillimi i takimeve periodike të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit Parlamenti Europian–Kuvendi i Shqipërisë (KPSA), duke respektuar procedurat e parashikuara në MSA dhe në Rregulloren e Funksionimit të KPSA-së. | Numri i takimeve në vit (zakonisht 2 takime në vit) | Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë në KPSA;<br>SHMJ. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.4.3 Zhvillimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërparlamentare përmes aktiviteteve të komisioneve parlamentare dhe grupeve të miqësisë.<br>- Hartimi i planit/ kalendarit të aktiviteteve/ vizitave/ konferencave për çdo komision/ grup miqësie në përputhje me planin vjetor të veprimtarive ndërkombëtare të institucionit. | Numri i vizitave, shkëmbimeve dhe projekteve të bashkëpunimit.<br>Plotësimi i grupeve të miqësisë. | Komisionet e Përhershme të Kuvendit;<br>SHMJ;<br>Shërbimi i Komisioneve. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II.4.4 Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive e deputetëve në organizatat ndërkombëtare. | Shpeshtësia e pjesëmarrjes së deputetëve në aktivitetet e organizatave shumëpalëshe.<br><br>Raporte të takimeve të zhvilluara. | Delegacionet e përhershme të Kuvendit; grupet parlamentare; SHMJ. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.4.5 Sesione trajnimi/ informimi/ orientimi për deputetët në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe diplomacisë parlamentare. | Numri i trajnimeve/ *workshop*-eve/ seminareve.<br><br>Numri i të trajnuarve. | Deputetët; SHMJ; MEPJ. | 2020–2025 | Donatori/partneri<br><br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| II.4.6 Hartimi i një udhëzuesi për praktikat më të mira për funksionimin e grupeve ndërparlamentare të miqësisë. | Udhëzuesi i hartuar dhe miratuar. | SHMJ | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |

| **FUSHA PRIORITARE III:<br>TRANSPARENCA, PJESËMARRJA DHE EDUKIMI QYTETAR NË VEPRIMTARINË E KUVENDIT** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi strategjik:<br>Rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit** | | | | |
| **Aktivitetet** | **Treguesit** | **Struktura përgjegjëse** | **Afati kohor** | **Efekti financiar shtesë** |
| **Objektivi strategjik 1:<br>Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare.** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| III.1.1 Hartimi i planit periodik të komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare për zhvillimin e takimeve informuese me grupet e interesit jashtë Kuvendit sipas fushave të përgjegjësisë. | Hartimi i dy planeve për çdo sesion parlamentar. | Komisionet parlamentare;<br>deputetët;<br>Shërbimi i Komisioneve. | Çdo fillim sesioni (shtator dhe janar). | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.2 Organizimi i takimeve periodike të qytetarëve me deputetët për të prezantuar veprimtarine e Kuvendit. | Numri i takimeve (10 jave të gjelbra). | Deputetët;<br>Trajtimi i Deputetëve;<br>stafi i grupeve parlamentare. | 2020 - 2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.3 Miratimi i Deklaratës Globale për Parlament të Hapur, si angazhim i Kuvendit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. | Deklarata e miratuar. | Kuvendi;<br>Shërbimi Legjislativ.<br>SHMP. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.4 Krijimi i Grupit mbi Transparencën Legjislative dhe Parlamentin e Hapur në linjë me praktikat më të mira në kuadër të Partneritetit Global për Qeverisje të Hapur (OGP). Grupi përbëhet nga deputetë, nëpunës të Kuvendit dhe përfaqësues të shoqërisë civile. | Vendimi i Byrosë i miratuar. | Byroja e Kuvendit;<br>Sekretariati për Transparencën. dhe Teknologjinë e Informacionit;<br>Shërbimi Legjislativ;<br>Shërbimi i Informacionit dhe Dokumentacionit. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.5 Realizimi i një vlerësimi gjithpërfshirës mbi gjendjen aktuale në fushën e transparencës, qasjes dhe llogaridhënies. | Raporti i hartuar. | Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit STIT);<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>SHMP. | Muaji mars i çdo viti. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| III.1.6 Rishikimi i Programit të Transparencës. | Programi i rishikuar. | STIT;<br>SHMP | 2021-2022 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.7 Interpretimi në gjuhën e shenjave për personat me aftësi ndryshe në seancë penare. | Minuta te traskriptuara në gjuhën e shenjave. | SHMP;<br>RTSH;<br>Shoqata e gjuhës së shenjave. | Sipas kalendarit të seancave plenare (2020–2025). | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.1.8 Hartimi dhe miratimi i raportit vjetor për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit:<br>a) Zhvillimi i takimeve/tryezave të konsultimi me shoqërinë civile për projektraportin vjetor përpara miratimit të tij në Byro;<br>b) Vlerësim për shkallën e zbatimit të Manualit për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje. | Raporti i miratuar. | Byroja Kuvendit;<br>Shërbimi i Komisioneve. | Muaji mars i çdo viti. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.1.9 Zbatimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Transparencën dhe Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje nën kushtet e diktuara nga pandemia. | Zbatimi i masave përkatëse. | Grupi i punës. | Gjatë periudhës së pandemisë. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| **Objektivi strategjik 2:<br>Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e parlamentit.** | | | | |
| III.2.1 Ngritja dhe vënia në funksion e Qendrës së Vizitorëve në Sallën e Seancës Plenare.<br>- Ngritja dhe vënia në funksion e Punishtes së Demokracisë. | Qendra e ngritur.<br>Punishtja e Demokracisë e ngritur sipas modelit të parlamentit austriak. | SHMP. | 2020–2021<br>2020–2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| III.2.2 Vijimi i planifikimit dhe organizimit të takimeve të hapura sipas tematikave në Kuvend dhe jashtë Kuvendit. | Jo më pak se 4 takime të hapura në 1 legjislaturë. | Komisionet e përhershme;<br>Shërbimi i Komisioneve;<br>SHMP;<br>Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve. | 2020–2025. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.2.3 Simulim debati (loja) "Këndvështrimi IM" në bashkëpunim me institucionet arsimore. | 6 tematika në vit "Loje"të stimuluara. | SHMP;<br>sektori i projekteve. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.2.4 Simulim i procesit ligjbërës me studentë të fakulteteve të universiteteve publike dhe private në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe universiteteve publike dhe private. | 2 seanca të simualuara gjatë një sesioni. | Komisioni i Ligjeve;<br>Shërbimi Legjislativ;<br>Universitetet. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.2.5 Zhvillimi i tureve me tematika të ndryshme në mjediset e Kuvendit. | 10 ture gjatë një viti. | SHMP | 2020–2025. | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.2.6 Prezantimini i funksioneve të Kuvendit në shkollën 1 javore "Akademia e Voskopojës". | Deri në 4 përfaqësues nga shërbimet. | Shërbimet e Kuvendit | 2020–2025. | Donatori/partneri<br>Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.2.7 Zhvillimi i *Democracy Workshops* në bashkëpunim me institucionet arsimore, grupet rinore dhe universitetet publike dhe ;private. | 2 *workshop*-e në vit. | Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve;<br>SHMP;<br>Institucionet Arsimore. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/ Partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| III.2.8 Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut lidhur me angazhimet e Kuvendit. | Zbatimi nga Kuvendi i 7 masave të Planit të Veprimit 2020–2023, për të cilat është institucion përgjegjës. | Shërbimi legjislativ. | 2020-2023 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.2.9 Organizimi i ditëve të dyerve të hapura në Kuvend. | Të paktën 4 ditë të hapura të Kuvendit në vit. | SHMP | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.2.10 Rishikimi i Strategjisë së Komunikimit si dhe monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit. | Raporti i rishikimit. | Byroja e Kuvendit;<br>STIT;<br>SHMP | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| **Objektivi strategjik 3:<br>Promovimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse me anë të teknologjisë së informacionit.** | | | | |
| III.3.1 Krijimi dhe implementimi i një motori kërkimi në faqen e internetit. | Roadmap i finalizuar. | Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.3.2 Kategorizimi dhe publikimi i informacionit parlamentar në formatin *Open Data*. | Përfundimi i katalogut *online* të të dhënave. | IT;<br>SHMP;<br>Shërbimi Legjislativ. | 2020–2025 | Kuvendi- Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.3.3 Riinxhinierizimi i paraqitjeve publike *online* të informacionit parlamentar përmes teknologjisë së informacionit (IT) për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. | Rindërtimi i faqes Web të Kuvendit. | STTI;<br>Shërbimi i IT-së;<br>SHMP. | 2020 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/ Partneri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| III.3.4 Ngritja e platformës online "*Rubrika 'Zëri i Qytetarit'* sipas eksperiencave më të mira. | Integrimi i platformës në faqen e re *web* të Kuvendit | STTI;<br>Shërbimi i IT-së;<br>SHMP. | 2021 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.3.5 Zhvillimi dhe promovimi i Turit Virtual. | Numri i klikimeve. | IT;<br>SHMP. | 2021–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri |
| III.3.6 Krijimi i profileve *online* në kanalet e mediave sociale për pasqyrimin e veprimtarive të Kuvendit. | Facebook/<br>Twiter/ YT | IT;<br>SHMP. | 2020–2025 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.3.7 Bërja efektive e faqes zyrtare të internetit të Kuvendit në anglisht. | Faqja e internetit të Kuvendit bëhet efektive edhe në anglisht. | SHMP;<br>SHMJ. | 2021-2022 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet. |
| III.3.8 Hapja e një dyqani online "*online shop*" për të mundësuar shitjen e artikujve me logon e Kuvendit si dhe të botimeve/dokumenteve që publikon/prodhon Kuvendi (përmbledhje e diskutimeve parlametnare për reformat e realizuara nga Kuvendi; Rregullore, revista "Kuvendi" etj.) | Numri i produkteve dhe i botimeve të shitura. | Byroja e Kuvendit;<br>IT;<br>SHMP;<br>Shërbimi i Botimeve. | 2024 | Kuvendi - Nuk ka kosto shtesë në buxhet.<br>Donatori/partneri. |
